

### Përmbledhje

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale në gjysmën e parë të vitit 2020 shënoi rënie prej 4.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar investimet dhe eksportet neto, përderisa konsumi ka shënuar rritje. Përkundër hapjes së ekonomisë në tremujorin e dytë, vlerësohet se trendi i rënies së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM3 2020. Këto vlerësime mbështeten në rënien eksportit të shërbimeve, rënien e shpenzimeve kapitale të qeverisë, rënien e IHD-ve, etj. Indikacion i rënies së kërkesës së brendshme është edhe rënia e importit të mallrave, ndërsa pavarësisht krizës së pandemisë, remitencat si dhe eksporti i mallrave kanë shënuar rritje.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar shënuan rritje për 258.8 milionë euro në TM3 2020, duke i'u atribuar kryesisht rritjes së shënuar në aktivitetin e sektorit bankar dhe atij pensional. Rritja e aseteve të sektorit bankar u mbështet kryesisht nga depozitat e arkëtuara në këtë tremujor, përderisa rritja e aseteve të sektorit pensional i'u atribua kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe.

Aktiviteti kreditues u karakterizua me rritje tremujore më të theksuar për ekonomitë familjare kundrejt korporatave jofinanciare. Kreditë e reja gjatë TM3 2020 shënuan rritje të theksuar vjetore si për ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet, megjithëse një pjesëmarrje e lartë e kredive të lëshuara në këtë periudhë janë kredi të riprogramuara. Sektori bankar shënoi fitim neto në vlerë prej 17.6 milionë euro në këtë tremujor, që është për 7.7 milionë euro më i ulët krahasuar me TM3 2019, kryesisht si pasojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave të sektorit. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera të kënaqshme. Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore dhe me mbulueshmëri optimale me provizione. Indikatorët e solvencës dhe likuiditetit vazhdojnë të jenë mbi

nivelin minimal të përcaktuar me kornize ligjore (prej 12.0 përqind përkatësisht 25.0 përqind).

Sektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit edhe gjatë TM3 2020, si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit pozitiv nga investimet në dy tremujorët e fundit. Edhe sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me TM3 2019. Vlera e primeve të arkëtuara shënoi rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe. Kurse, vlera e dëmeve të paguara dhe atyre të ndodhura ishte dukshëm më e lartë krahasuar me periudhën paraprahe.

Sektori mikrofinanciar ka shënuar ngadalësim të theksuar të rritjes së aktivitetit gjatë TM3 2020, si dhe performancë financiare më të ulët krahasuar me periudhën paraprahe. Megjithatë, sektori vazhdon të ketë cilësi të mirë të portfolios kreditore, megjithëse ka ndryshuar kahje, krahasuar me trendin e periudhave të kaluara.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë më të ulët krahasuar me tremujorin paraparak (TM2 2020) dhe nivelin e emetuar gjatë TM3 2019. Kjo dinamikë kryesisht i'u atribua rënies së kërkesës së Qeverisë të Kosovës për të financuar aktivitetin e saj përmes këtij instrumenti. Gjithashtu, kërkesa më e ulët për emetim të borxhit të brendshëm mund t'i atribuohet edhe rritjes së nivelit të huazimeve nga jashtë, vlera e të cilave deri në tetor të vitit 2020 arriti në 130.7 milionë euro, kurse vlera e përgjithshme në vitin e kaluar kishte arritur në vetëm 42.9 milionë euro.

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje	i
Zhvillimet Makroekonomike	5
<b>Sistemi Financiar</b>	<b>6</b>
Sektori Bankar	6
Asetet	7
Performanca e sektorit bankar	12
<b>Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar</b>	<b>14</b>
Sektori pensional	16
Sektori i sigurimeve	18
Performanca e sektorit të sigurimeve	19
Sektori mikrofinanciar	19
Asetet	20
Performanca e sektorit mikrofinanciar	22
Tregu i letrave me vlerë	23

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	06
Figura 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar	06
Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës	07
Figura 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive	08
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike	08
Figura 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare	08
Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake	09
Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore	09
Figura 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore	10
Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita	10
Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj korporatave	11
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare	11
Figura 13. Norma e interesit në depozita	11
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare	11
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare	12
Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	12

Figura 17. Treguesit e cilësisë së portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	13
Figura 18. Treguesit e solvencës -----	13
Figura 19. Treguesit e likuiditetit -----	13
Figura 20. Asetet e sektorit pensional -----	16
Figura 21. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	17
Figura 22. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	17
Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	17
Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	18
Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	19
Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	20
Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare -----	20
Figura 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	21
Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	22
Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	22
Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	23
Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar -----	23
Figura 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	24
Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	24
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	26

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zviceran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

## Zhvillimet Makroekonomike<sup>1</sup>

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale në gjysmën e parë të vitit 2020 shënoi rënie prej 4.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar komponenta e investimeve dhe eksporteve neto, ndërsa konsumi ka shënuar rritje. Përkundër hapjes së ekonomisë, vlerësohet se trendi i rënies së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM3 2020. Këto vlerësime mbështeten në rënien eksportit të shërbimeve, rënien e shpenzimeve kapitale të qeverisë, rënien e IHD-ve, etj. Indikacion i rënies së kërkesës së brendshme është edhe rënia e importit të mallrave, ndërsa pavarësisht krizës së pandemisë, remitencat si dhe eksporti i mallrave kanë shënuar rritje.

Çmimet e konsumit shënuan rënie prej 0.4 përqind në TM3 2020, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të transportit, rekreacionit, orendive, veshmbathjes, energjisë, etj. Rritje të ngadalësuar të çmimeve kanë shënuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike duke bërë që inflacioni bazë të jetë më i ulët (-0.9 përqind) se sa inflacioni i përgjithshëm.

Sektori fiskal në TM3 2020 u karakterizua me rënie të të hyrave buxhetore prej 13.5 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 11.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 86.4 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 12.2 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2019. Si

përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 19.9 përqind, nga 17.4 përqind sa ishte në TM3 2019.

Sektori i jashtëm është karakterizuar me deficit të llogarisë rrjedhëse prej 90.9 milionë euro, që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve, i cili ishte dukshëm më i ulët. Në anën tjetër, deficit i mallrave ishte më i ulët si dhe bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ishin më të larta. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje vjetore prej 18.1 përqind, ndërsa IHD-të shënuan rënie prej 27.0 përqind gjatë TM3 2020.

---


<sup>1</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM3 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

## Sistemi Financiar

*Asetet e sistemit financiar në fund të shtatorit 2020 arritën vlerën në 7.67 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.5 përqind (figura 1). Ngadalësimi i evidentuar në rritjen e aseteve të sistemit financiar kryesisht reflekton ecurinë e institucioneve kredidhënëse, të cilat u ndikuan deri në një masë nga efektet negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19.*

Sektori bankar, pavarësisht ngadalësimit të rritjes së aktivitetit, kishte kontributin më të lartë në rritjen prej 9.5 përqind të aseteve të sistemit financiar. Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha, kishte kontributin e dytë më të rëndësishëm në rritjen e aktivitetit të sistemit; pasuar nga sektori mikrofinanciar dhe i sigurimeve.

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
 Burimi: BQK (2020)

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 258.8 milionë euro, kryesisht ndikuar nga aktiviteti i sektorit bankar (+187.0 milionë euro) dhe sektorit pensional (+64.1 milionë euro), dhe në masë më të ulët nga sektorët tjerë (+7.7 milionë euro) (figura 2).

Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar në këtë tremujor i atribuohet kryesisht ecurisë së depozitave, të cilat shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën paraprake (TM3 2019). Në anën tjetër, rritja e sektorit pensional në këtë tremujor i'u atribuua kryesisht kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe. Vlen të theksohet që ky sektor rikuperoi në tërësi humbjet nga investimet të shkaktuara gjatë TM1 2020 (si rrjedhojë e luhatjeve dhe pasigurisë së shkaktuar në tregjet e jashtme rezultat i përhapjes së pandemisë Covid-19 nga fillim viti 2020).

Figura 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar




## Sektori Bankar

*Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, bilanci me bankat komerciale shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga aktiviteti kreditues, para e gatshme dhe investimet në letrat me vlerë. Depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, shënuan rritje të ngadalësuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizuan edhe burimet vetanake të bankave (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar) dhe huazimet prej bankave tjera (kryesisht prej sektorit të jashtëm). Në përgjithësi, sektori*

*bankar vazhdoi të jetë mirë i kapitalizuar, likuid dhe me cilësi të lartë të portfolios kreditore, përkundër rreziqeve të rritura si pasojë e krizës ekonomike dhe sociale të nxitur nga pandemia Covid-19.*

Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tre mujorët përkatës



## Asetet

Vlera e gjithsej aseteve të sektorit bankar në fund të TM3 2020 arriti në 5.04 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.0 përqind. Në baza tremujore, asetet e sektorit bankar u rritën për 187.0 milionë euro gjatë TM3 2020. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar (që zë peshën më të madhe në kuadër të aseteve të sektorit me pjesëmarrje prej 63.2 përqind) ka shënuar rritje për 55.1 milionë euro në këtë tremujor (figura 3). Kategorja e bilancit me bankat komerciale, që janë kryesisht depozita dhe të ngjashme të investuara në bankat jashtë vendit, shënoi rritjen më të theksuar në këtë tremujor, për 82.0 milionë euro. Paraja e mbajtur në trezor dhe në BQK shënoi rritje për 28.9 milionë euro në këtë tremujor, përderisa investimet në letrat me vlerë u rritën për vetëm 26.7 milionë euro.

Në përgjithësi, si pasojë e pasigurisë së shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, megjithë rritjen e aktivitetit kreditues në TM3, sektori bankar ka mbajtur një pjesë të konsiderueshme të mjeteve në para të gatshme dhe të ngjashme (në trezor, BQK dhe bankat tjera). Për më tepër, vlera e stokut të kësaj kategorie, deri në shtator 2020 ka arrit vlerën prej 637.1 milionë euro, e që është niveli më i lartë historikisht në sektorin bankar të Kosovës.


## Kreditë

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të TM3 2020 arriti në 3.18 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6 përqind (rritje prej 10.3 përqind në fund të TM3 2019). Për herë të parë në katër vitet e fundit, aktiviteti kreditues u karakterizua me ngadalësim të dinamikës së rritjes nga një rritje dyshifrore në njëshifrore. Kjo dinamikë e rritjes dyshifrore të kreditimit u ndërpre që nga muaji mars 2020, kur edhe filluan masat e para të marra për të luftuar pandeminë Covid-19. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, që përbëjnë 63.2 përqind të gjithsej kredive, shënuan rritje vjetore prej 7.9 përqind në fund të shtatorit 2020 (9.9 përqind në periudhën paraprake).

Ngjashëm, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 7.6 përqind gjatë kësaj periudhe (rritje vjetore prej 10.8 përqind në fund të shtatorit 2019).

Vetëm gjatë TM3 2020, gjithsej kreditë u rritën për 55.1 milionë euro, kundrejt rritjes prej 17.2 milionë euro në TM3 2019. Kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 30.7 milionë euro (20.5 milionë euro gjatë TM3 2019), përderisa kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 23.7 milionë euro (-6.0 milionë euro gjatë TM3 2019) (figura 4).


**Figura 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive**



Burimi: BQK (2020)

Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, vetëm kreditimi ndaj sektorit të shërbimeve tjera dhe atë të energjetikës, gazit, etj., shënuan rënie. Me rritje të kreditimit në këtë tremujor u karakterizuan sektori i prodhimtarisë, pasuar nga sektori i ndërtimtarisë, tregtisë, shërbimeve financiare dhe të bujqësisë. (figura 5).

**Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike**




Burimi: BQK (2020)

Kreditë e reja në TM3 2020 arritën vlerën prej 484.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 30.3 përqind krahasuar me TM3 2019. Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 29.6 përqind dhe arritën vlerën prej 313.4 milionë euro (figura 6). Rritje të theksuar shënuan kreditë për qëllime investuese, prej 60.3 përqind, vlera e të cilave arriti në 211.1

milionë euro. Kurse, kreditë e reja për qëllime joinvestuese u karakterizuan me rënie vjetore prej 9.6 përqind dhe shënuan vlerën prej 95.8 milionë euro. Në aspekt sektorial, të gjitha kategoritë shënuan rritje vjetore krahas TM3 2019, në veçanti kreditë e reja për sektorin e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve tjera.

**Figura 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare në TM3**



Burimi: BQK (2020)

Me rritje të theksuar u karakterizuan kreditë e reja ndaj ekonomive familjare. Vlera e gjithsej kredive të reja ishte për 41.3 milionë euro më e lartë kundrejt TM3 2019, duke arritur vlerën prej 171.1 milionë euro në TM3 2020. Prej tyre, kreditë e reja me qëllim konsumi shënuan rritjen më të theksuar prej 37.5 përqind, dhe arritën vlerën prej 126.2 milionë në TM3 2020. Me rritje prej 23.7 përqind u karakterizuan edhe kreditë e reja hipotekare, që arritën vlerën prej 34.4 milionë euro në fund të TM3 2020. Dinamikat e evidentuara në kreditë e reja të lëshuara gjatë TM3 marrin për bazë edhe kreditë e riprogramuara nga sektori bankar gjatë kësaj periudhe, si masë lehtësuese emergjente të ndërmarrë nga BQK për të mundur shtyrjen/moratoriumin e borxhit të klientëve bankar dhe zbutjes së efektit të pandemisë COVID-19 edhe tek institucionet kredidhënëse e edhe tek klientët bankar. Si rrjedhojë, gjatë periudhës prill-gusht 2020 në




mesatare, rreth 40.3 përqind e total stokut të kredive ishin kredi të riprogramuara kurse niveli i tyre gjatë muajit shkurt 2020 ishte vetëm 2.3 përqind.

### Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (80.5 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit shtator 2020 arriti në 4.06 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore të përgjysmuar prej 8.6 përqind (16.4 përqind në shtator 2019). Edhe në baza tremujore, depozitat shënuan rritje më të ngadalësuar për 152.2 milionë euro, kundrejt rritjes prej 310.3 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 7). Kategoria e burimeve vetanake të sektorit u rrit për 19.0 milionë euro në TM3 2020 (8.1 milionë euro në TM3 2019), si rrjedhojë e fitimit të realizuar gjatë këtij tremujori. Në fund të muajit shtator 2020, stoku i gjithsej ekuitetit arriti vlerën prej 589.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.5 përqind.

Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2020)


Në kuadër të kategorive tjera të detyrimeve, borxhi i ndërvarur u zvogëluar për 0.7 milionë euro (-0.8 milionë euro në TM3 2019), kurse huazimet nga bankat

komerciale u rritën për 13.1 milionë euro (-27.0 milionë euro në TM3 2019).

### Depozitat

Stoku i gjithsej depozitave në shtator 2020 shënoi rritje vjetore prej 8.6 përqind, e që paraqet përgjysmim të nivelit të rritjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (prej 16.4 përqind). Kjo rritje dukshëm më e ngadalësuar e depozitave krahasuar me periudhën parapake u ndikua në masën më të madhe prej depozitave të ekonomive familjare, pasuar nga ato të korporatave jofinanciare dhe atyre financiare, që po ashtu shënuan ngadalësim të rritjes.

Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM3




Burimi: BQK (2020)

Gjatë TM3 2020, gjithsej depozitat u rritën për 152.2 milionë euro, kundrejt rritjes prej 310.3 milionë euro në TM3 2019. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje për 54.1 milionë euro në TM3 2020 dhe arritën vlerën prej 2.70 miliardë euro në fund të periudhës (shtator 2020) (figura 8). Kurse, depozitat e korporatave jofinanciare në këtë tremujor u rritën për 67.1 milionë euro dhe arritën vlerën prej 717.3 milionë euro në fund të periudhës (shtator 2020). Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u zgjeruan në vlerë prej 149.7 milionë euro (+233.3

milionë euro në TM3 2019) në baza tremujore, kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.49 miliardë euro në fund të periudhës (shtator 2020) (figura 9).

Ndërsa, depozitat e afatizuara gjatë kësaj periudhe u tkurrën për 6.7 milionë euro (zgjerim për 75.2 milionë euro gjatë TM3 2019), duke arritur vlerën prej 1.04 miliardë euro në fund të periudhës (shtator 2020). Depozitat e kursimeve gjatë këtij tremujori u zgjeruan për 9.1 milionë euro (+1.5 milionë euro gjatë TM3 2019), duke arritur vlerën prej 525.1 milionë euro në fund të periudhës (shtator 2020). Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (61.5 përqind), pasuar nga depozitat e afatizuara (25.6 përqind) dhe të kursimit (12.9 përqind).

**Figura 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor**



Burimi: BQK (2020)


Vlera e depozitave të reja të arkëtuara gjatë TM3 2020 arriti vlerën prej 150.7 milionë euro, prej të cilave 41.8 milionë euro ishin depozita të arkëtuara nga korporatat jofinanciare, ndërsa 108.9 milionë euro depozita të arkëtuara nga ekonomitë familjare. Kurse, krahasuar me TM3 2019, kemi rënie të theksuar si për

ekonomitë familjare (-27.7 milionë euro) ashtu edhe për korporatat jofinanciare (-22.5 milionë euro).

### Normat e Interesit<sup>2</sup>

Norma mesatare e interesit në kredi në TM3 2020 ishte 6.2 përqind, apo 0.2 pikë përqindje më e ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake, në 1.4 përqind në TM3 2020. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.8 pikë përqindje (figura 10).

**Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita**



Burimi: BQK (2020)

### Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë për korporatat jofinanciare qëndroi në 6.0 përqind gjatë TM3 2020, apo për 0.1 pikë përqindje më e ulët se në vitin paraprak (figura 11).


Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e ulët (6.0 përqind) krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.2 përqind). Krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, vërehet rënie më e theksuar në normën

<sup>2</sup>Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

e interesit për kreditë jo-investive (për 0.22 pikë përqindje) krahasuar me rënien për kreditë investive (për 0.21 pikë përqindje).

Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rënie për 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në mesataren prej 6.6 përqind.


Figura 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare



Burimi: BQK (2020)

Norma e interesit në kreditë industriale dhe shërbyese mbetën të ngjashme me vitin e kaluar, prej 6.0 përqind, përkatësisht 6.1 përqind.

Figura 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare



Burimi: BQK (2020)


Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 6.4 përqind, që paraqet një rënie për 0.6 pikë përqindje krahasuar me TM3 2019. Norma më e lartë e interesit ishte për kreditë konsumuese (6.6 përqind), që shënoi rënie për 0.6 pikë përqindje

krahasuar me TM3 2019. Për më shumë, edhe norma e interesit në kreditë hipotekare shënoi rënie gjatë këtij tremujori (prej 5.9 përqind në TM3 2019 në 5.5 përqind në TM3 2020) (figura 12).

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në nivel të ngjashëm krahasuar me periudhën paraprake, në 1.4 përqind (figura 13).


Figura 13. Norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2020)

Normat e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare gjatë TM3 2020 ishte më e favorshme krahasuar me ato për ekonomitë familjare, edhe pse dallimi mes tyre ishte marxhinal.

Figura 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2020)

Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare ishte e ngjashme me vitin e kaluar, duke qëndruar në 1.6 përqind. (figura 14).

Ngjashëm, edhe normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbetën të ngjashme në këtë tremujor krahasuar me periudhën paraprake (TM3 2019). Norma mesatare e interesit qëndroi në 1.4 përqind, ngjashëm me normën për depozitat e afatizuara, kurse ato të kursimit në 0.4 përqind (figura 15).

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2020)

### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në TM3 2020 realizoi profit në vlerë prej 17.6 milionë euro, e që është për 7.7 milionë euro më i ulët krahasuar me TM3 2019 (figura 16). Fitimi më i ulët i realizuar në TM3 2020 ishte kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve (për 8.9 milionë euro) krahasuar me rritjen e të hyrave (për 1.2 milionë euro). Të hyrat gjatë këtij tremujori arritën vlerën në 71.2 milionë euro, ku të hyrat nga interesi (kryesisht të hyra nga interesi në kredi) arritën vlerën prej 54.1 milionë euro (rritje vjetore për 2.7 milionë euro). Kurse të hyrat nga jointerеси, të cilat kryesisht

janë të hyra nga tarifat dhe komisionet, shënuan vlerën prej 16.8 milionë euro, një rënie vjetore për 1.8 milionë euro. Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 53.6 milionë euro. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shënuan vlerën prej 26.4 milionë euro (për 0.4 milionë euro më e ulët se në TM3 2019). Kategoria e shpenzimeve të jointerесit në TM3 2020 arriti vlerën në 19.1 milionë euro (për 10.6 milionë më shumë se në periudhën paraprake), kryesisht si rrjedhojë e ndarjes më të lartë të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi. Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit arriti vlerën në 6.0 milionë euro (për 1.1 milionë euro më shumë se në periudhën paraprake).

Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2020)

Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt të hyrave, në TM3 2020 raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave arriti në nivel prej 75.2 përqind, apo 11.4 pikë përqindje më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar, sektori bankar shpenzon 0.752 euro (figura 16).

### Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të jenë në nivele të kënaqshme edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, pavarësisht rreziqeve në rritje të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Kreditë joperformuese, edhe pse kanë shënuar rritje krahasuar me tremujorët paraprak, niveli i tyre ndaj gjithsej kredive vazhdon të jetë i ulët dhe janë mjaftë mirë të provizionuara ndaj humbjeve të mundshme që mund të shkaktohen. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në shtator 2020 qëndroi në nivel prej 2.7 përqind (2.3 përqind në fund të shtatorit 2019) (figura 17). Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të provizionuara, në shkallë prej 137.8 përqind (161.3 përqind në fund të shtatorit 2019).


Figura 17. Treguesit e cilësisë të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe i qëndrueshëm. Gjatë kësaj periudhe, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 16.9 përqind, nivel ky më i lartë për 0.4 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 18). Rritja e lehtë e këtij treguesi i atribuohet rritjes më të lartë të gjithsej kapitalit krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të mjeteve të peshuara me rrezik.


Figura 18. Treguesi i solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi rënie të lehtë, për 3.9 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të TM3 2019, duke qëndruar në nivel prej 37.7 përqind. Rënia e lehtë e këtij indikator, erdhi si rezultat i rritjes më të përshpejtuar të detyrimeve afatëshkurtëra (kryesisht depozitave pa afat), krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme, bilanci me BQK dhe bilanci me bankat tjera). Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në nivel prej 78.5 përqind në fund të shtatorit 2020, që është i përafërt me nivelin e rekomanduar prej 80.0 përqind.

Figura 19. Treguesit e likuiditetit




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2020)

## Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit

### Bankar

Sektori bankar, deri para përhapjes së pandemisë Covid-19, ka operuar në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve. Përhapja e pandemisë Covid-19 që nga gjysma e dytë e muajit mars si dhe marrja e masave për parandalimin e saj në vazhdimësi, kanë ndikuar në rritjen e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar. Në këtë kuti tentohet të paraqitet efekti i pandemisë Covid-19 në ecurinë e treguesëve me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, të përmbledhura në Indeksin e Stabilitetit të Sektorit Bankar.

Figura 1. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK 2020

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar është ndërtuar me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas<sup>3</sup>. Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, sektori bankar në mesatare ka shënuar rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rënie të indeksit) në TM3 2020 krahasuar me TM3 2019. Vlera e përgjithshme e indeksit është në nivelin më të ulët (0.44) për herë të parë që nga TM3 2013 (figura 1). Po ashtu vlera e indeksit që nga TM1 2020 është nën mesataren historike, por që është rikuperuar dukshëm gjatë TM3 krahasuar me nivelin që kishte gjatë TM2.

Figura 2. Kriteret përbërëse të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK 2020

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, rënie të indeksit (lexo: rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënuan: indikatorin e rrezikut kreditor, profitabilitetit dhe likuiditetit. Ndërsa, rritje të indeksit (ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënoi indikatorin e rrezikut të solvencës. Kurse, indikatorin që matë rrezikun e tregut, që ka peshë mjaftë të ulët në indeksin e përgjithshëm, shënoi rritje të indeksit (rënie të ndjeshmërisë ndaj rrezikut), por duke marrë parasysh nivelin e ulët të mjeteve të mbajtura në valutë të huaj, kontributi i tij në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit është mjaftë i vogël. (figura 2).

<sup>3</sup> Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

**Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës** në fund të TM3 2020 krahasuar me gjendjen në fund të TM3 2019, i atribuohet rritjes së kapitalizimit të sektorit. Në rritje të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e kapitalit rregullativ kundrejt rritjes më të ngadalësuar të aseteve që bartin rrezik. Rritja e nivelit të kapitalit është rezultat i fitimit të pashpërndarë gjatë kësaj periudhe si dhe fitimit të realizuar deri në shtatorit të vitit 2020. Kurse, ngadalësimi i rritjes së aseteve që bartin rrezik është rezultat i ngadalësimit të rritjes së aktivitetit kreditues që nga fillimi i pandemisë krahasuar me ecurinë e viteve të fundit (rritje dyshifrore në tri vitet paraprake).

Figura 3. Indikator i solvencës




Burimi: BQK 2020

**Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit** në TM3 2020 krahasuar me nivelin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht i atribuohet rritjes më të ngadalësuar të mjeteve likuide krahasuar me rritjen më të lartë të detyrimeve afatshkurtra. Paraja e gatshme dhe mjetet e mbajtura në BQK nga bankat komerciale shënuan rritje më të ngadalësuar krahasuar me muajin shtator të vitit të kaluar. Përkundër kësaj, bankat komerciale vazhdojnë që të tejkalojnë nivelin minimal të detyruar të mjeteve që duhet të mbahen në BQK. Në anën tjetër, rritja më e theksuar e detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)

erdhi si rrjedhojë e rritjes së theksuar të depozitave të transferueshme krahasuar me ritmin e rritjes së depozitave të afatizuara dhe atyre të kursimit.

Figura 4. Indikator i likuiditetit



Burimi: BQK 2020


### Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor

erdhi si rezultat i rritjes së kredive joperformuese në nivel dhe vlerë, krahasuar me periudhën paraprake. Trendi rënës i vlerës së kredive joperformuese u ndërpre për herë të parë në TM1 2020, që nga TM4 2014 kur filluan të shënojnë rënie. Niveli i KJP-ve pritët të rritet edhe në periudhat në vijim, pasi që niveli aktual është i ulët, dhe në këtë rritje do të ketë ndikim dhe efekti i pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës. Kjo si rrjedhojë e zvogëlimit të të ardhurave të ekonomive familjare dhe të hyrave të bizneseve dhe veprimtarive tjera ekonomike. Në rritjen e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor ndikoi edhe rritja e nivelit të ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë krahasuar me periudhën paraprake (TM3 2019).

### Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit

kryesisht mund t'i atribuohet nivelit më të ulët të të hyrave të realizuara kundrejt rritjes së shënuar tek shpenzimet. Të hyrat e sektorit (kryesisht nga interesi) shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar. Masat lehtësuese të marra nga bankat


Figura 5. Indikator i rrezikut kreditor



Burimi: BQK 2020

për të ju mundësuar klientëve (individual dhe biznese) për shtyrje të kësteve kreditore ka ndikuar në profitin e realizuar nga ana e bankave. Rrjedhimisht, performanca financiare e realizuar deri në fund të TM3 2020 ka ndikuar edhe në indikatorët që matin profitabilitetin siç janë Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) dhe ai i shpenzimeve ndaj të hyrave.


Figura 6. Indikator i profitabilitetit



Burimi: BQK 2020

**Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut** i'u atribuu kryesisht zvogëlimit të pozicionit neto në valutë të huaj të sektorit bankar. Ky indikator ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak që vetëm 4.6 përqind e aseteve dhe 3.9 përqind e detyrimeve janë në valutë të huaj. Për më tepër, edhe niveli i kredive dhe depozitave në valutë të huaj është në nivel mjaftë të ulët. Si rrjedhojë, lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaftë të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar.

Figura 7. Indikator i rrezikut të tregut




Burimi: BQK 2020

## Sektori pensional

*Sektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ndikuar nga kthimi pozitiv nga investimet dhe kontributet e arkëtuara gjatë këtij tremujori.*

Figura 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2020)

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 27.1 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar. Gjithsej asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 8.5 përqind, duke arritur vlerën prej 2.08 miliardë euro në fund shtatorit 2020. Në baza tremujore, vetëm gjatë TM3 2020, asetet e sektorit pensional u rritën për 64.1 milionë euro (rritje prej 43.9 milionë euro në TM3 2019), si rezultat i kthimit pozitiv nga investimet dhe arkëtimeve prej kontribut-dhënësve (figura 20).




Figura 21. Struktura e asetëve të FKPK-së (TM3 2020)




Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP). Struktura e asetëve e FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, por që pesha e tyre krahasuar me periudhën paraprake shënoi rënie të konsiderueshme. Rreth 68.0 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit, apo rreth 1.41 miliardë euro të alokuara në fonde të përbashkëta investuese (figura 21). Pjesa e mbetur e mjeteve të investuara brenda vendit (32.0 përqind) janë rritur për 6.8 pikë përqindje kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak. Deri në fund të shtatorit 2020, vlera e investimeve brenda vendit arriti në 661.5 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në fletëobligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat vetëm gjatë TM3 2020, janë rritur për 40.5 milionë euro. Kategoria e mjeteve të deponuara në sektorin bankar është tkurrur për 12.4 milionë euro në këtë tremujor. Përderisa, paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës ka shënuar rritje për 19.3 milionë euro gjatë TM3 2020.

Figura 22. Struktura e asetëve të FSKP-së (TM3 2020)



Struktura e asetëve të FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (61.8 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (22.6 përqind) dhe asetëve tjera (figura 22). Gjithsej asetet e FSKP-së gjatë TM3 2020 u rritën për 123.2 mijë euro, prej të cilave pjesa më e madhe ishin investime në sektorin e brendshëm.

Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Gjatë TM2 dhe TM3 2020, FSKP rikuperoi në masë të madhe humbjet nga investimet të shënuara gjatë TM1 2020 (-910.0 mijë euro). Vetëm gjatë TM3 2020, FSKP-ja ka realizuar fitim bruto nga investimet në vlerë prej 171.9 mijë euro (220.4 mijë euro në TM3 2019). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit gjatë

TM3 2020 arriti në 133.7 mijë euro (137.5 mijë euro në TM3 2019).

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK-së u shtuan në vlerë prej 47.4 milionë euro, një rritje për 3.2 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Pas humbjeve të konsiderueshme që FKPK kishte nga investimet jashtë vendit në TM1 2020 (-90.4 milionë euro), tregjet financiare filluan rikuperimin dhe FKPK arriti të realizoj fitim rekord prej 70.3 milionë euro në TM2 2020 dhe 32.7 milionë euro në TM3 2020. Deri në shtator të vitit 2020, FKPK shënoi fitim neto nga investimet në vlerë prej 12.5 milionë euro.

### **Sektori i sigurimeve**


*Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 u karakterizua me rritje të aktivitetit, megjithëse në nivel më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e primeve të arkëtuara shënoi rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe përderisa vlera e dëmeve të paguara dhe atyre të ndodhura ishte dukshëm më e lartë krahasuar me periudhën paraprake. Si rrjedhojë, ky sektor gjatë TM3 2020 shënoi rezultate pozitive financiare, por në nivel më të ulët krahasuar me TM3 2019.*

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit shtator 2020 arritën vlerën në 214.3 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Kontributin më të lartë në rritjen e aseteve të sektorit e kishin kategoria e depozitave të mbajtura në sektorin bankar, pasuar nga investimet në letrat me vlerë dhe asetet tjera të prekshme. Ndërsa, në baza

tremujore, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 5.6 milionë euro gjatë TM3 2020 (figura 24). Edhe në baza tremujore, rritja u mundësua kryesisht prej depozitave të mbajtura në bankat komerciale, pasuar nga asetet tjera të paprekshme, dhe investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Ngjashëm me asetet, edhe niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali shënoi rritje prej 0.9 milionë euro, duke arritur vlerën prej 57.4 milionë euro në fund të periudhës (shtator 2020). Kjo rritje e kapitalit i'u atribuua shtimit të kapitalit aksionar të paguar dhe fitimit të realizuar në këtë periudhë. Ndërsa, niveli i lartë i humbjeve të akumuluar nga vitet e kaluara ka ndikuar negativisht në rritjen e mëtejme të kapitalit të sektorit të sigurimeve.

Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2020)

Sa i përket detyrimeve, ato u karakterizuan me rritje gjatë këtij tremujori (+4.7 milionë euro), e që kryesisht janë rezerva teknike; kurse vlera e gjithsej detyrimeve në fund të shtatorit 2020 arriti në 156.9 milionë euro. Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në tremujorin e tretë të vitit 2020 arriti në 26.9 milionë euro, një rritje vjetore prej 1.0 përqind (7.3

përqind rritje vjetore gjatë TM3 2019) (figura 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 96.6 përqind të gjithëj primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 3.4 përqind. Ngadalësim i theksuar i rritjes së primeve të shkruara kryesisht reflekton efektet e COVID-19 në ekonomi. Si rrjedhojë, vetëm gjatë TM3 2020, sektori i sigurimeve shiti polica ('jo-jetë') në numër prej 219.9 mijë sosh, kurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 415.1 mijë.


Ngjashëm me nivelin e primeve të shkruara, edhe dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar gjatë këtij tremujori. Vlera e tyre në fund të TM3 2020 arriti në 13.6 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 4.9 përqind (12.4 përqind rritje vjetore gjatë TM3 2019) (figura 25). Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të dëmeve të paguara krahasuar me atë të primeve të fituara, raporti dëme/prime gjatë TM3 2020 u përkeqësua, duke u rritur për 1.9 pikë përqindje, në 50.4 përqind në TM3 2020 (figura 25).

## Performanca e sektorit të sigurimeve

Gjatë TM3 2020, sektori i sigurimeve performoi me fitime neto në vlerë prej 172.9 mijë euro (fitim në vlerë prej 2.0 milionë euro në TM3 2019). Fitimi i ulët i realizuar në këtë tremujor i'u atribua rritjes më të ulët të primeve të shkruara kundrejt rritjes më të lartë të dëmeve të ndodhura. Përderisa, shpenzimet operative shënuan rënie të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe dhe ndikuan që sektori të ketë performancë pozitive financiare gjatë kësaj periudhe.

Sa i përket nivelit të likuiditetit, sektori i sigurimeve shënoi përmirësim të ndjeshëm krahasuar me gjendjen që kishte deri në shtator të vitit të kaluar. Raporti i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike tregon që likuiditeti ka qëndruar në nivel prej 101.5 përqind, për 5.4 pikë përqindje më i lartë se në shtator të vitit 2019. Për më tepër, edhe treguesi tjetër i likuiditetit, raporti i parasë dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithëj detyrimeve, tregon një rritje prej 2.3 pikë përqindje në nivel të sektorit krahasuar me gjendjen deri në shtator 2019, duke arritur në 86.8 përqind në fund të muajit shtator 2020.

Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara




## Sektori mikrofinanciar

*Sektori mikrofinanciar ka shënuar ngadalësim të theksuar të rritjes së aktivitetit dhe performancë financiare më të ulët gjatë TM3 2020 kundrejt vitit paraprak. Sektori vazhdon të ketë cilësi të mirë të portfolios kreditore, megjithëse me tendencë për ndryshim të kahjes.*

## Asetet

Pas katër vitesh rritjeje dinamike të sektorit, në shtator të këtij është shënuar ngadalësim i theksuar i aktivitetit të institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare. Në shtator 2020, vlera e aseteve arriti në 323.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.8 përqind (27.1 përqind rritje vjetore në shtator 2019). Në baza tremujore, asetet u rritën për 5.2 milionë euro, e në krahasim me TM3 2019, kjo vlerë ishte më e ulët për 10.1 milionë euro.

Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2020)

Rritja më e ngadalësuar vjetore e aseteve të sektorit gjatë TM3 2020 i'u atribuua kryesisht pasojave të shkaktuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e vendit, reflektuar në nivel më të ulët të huazimeve të marra nga sektori i jashtëm. Rënia e nivelit të huazimeve nga jashtë u reflektua në rënie të kreditimit dhe rritje më të ngadalësuar të aktivitetit të lizingjeve. Për pasojë, gjatë kësaj periudhe, është shënuar rritje e theksuar e kategorisë së parasë së gatshme dhe asaj të mbajtur në bankat komerciale (figura 26).

## Kreditë

Në baza vjetore, gjithsej kreditë shënuan rritje për 2.0 përqind në fund të muajit shtator 2020 përdherisa stoku i tyre shënoi vlerën prej 218.8 milionë euro. Krahasuar me periudhën paraprake, kreditë shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes, dinamikë e përkthyer tek të dy kategoritë: korporatat jofinanciare dhe ekonomive familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje prej 2.6 përqind (27.3 përqind rritje vjetore deri në shtator 2019), dhe arriti vlerën prej 149.1 milionë euro në fund të shtatorit 2020. Vlera e gjithsej kredive, në baza tremujore, u zvogëlua për 1.7 milionë euro gjatë TM3 2020, krahasuar me rritjen për 8.9 milionë euro gjatë TM3 2019. Vetëm gjatë TM3 2020, kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluan për 1.0 milionë euro (figura 27).

Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, ndryshimi vjetor i kredive




Burimi: BQK (2020)

Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare në fund të shtatorit 2020 shënoi vlerën prej 69.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 0.8 përqind (rritje vjetore prej 16.1 përqind deri në shtator 2019). Në baza tremujore, gjatë TM3 2020, kreditë ndaj korporatave jofinanciare u zvogëluan për 0.8 milionë euro.

Në aspekt sektorial, në baza tremujore, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe shërbimeve tjera shënuan

rritje, edhe pse në nivel më të ulët se në periudhën paraprake. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë, industrisë dhe tregtisë u karakterizuan me rënie vjetore gjatë TM3 2020 (figura 28).


Figura 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor



### Lizingjet

Për dallim nga zhvillimet në kreditim, institucionet mikrofinanciare ruajtën në masën më të madhe trendin e rritjes së aktivitetit të lizingjeve gjatë kësaj periudhe.

Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Aktiviteti i lizingut në sektorin mikrofinanciar shënoi rritje në vlerë prej 2.0 milionë euro gjatë TM3 2020 (3.1 milionë euro në TM3 2019), dhe arriti vlerën prej 56.7 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje kryesisht


reflekton lizingun ndaj korporatave jofinanciare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 1.6 milionë euro dhe arriti në 31.0 milionë euro në fund të periudhës (figura 29).

Njëkohësisht, edhe lizingu ndaj ekonomive familjare u shtua për 0.5 milionë euro në TM3 2020, duke rritur vlerën e përgjithshme në 25.7 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

### Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 20.0 përqind, apo për 0.4 pikë përqindje më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 30).


Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Tek ekonomitë familjare, norma e interesit shënoi rritje marginale, për 0.2 pikë përqindje, në 21.1 përqind gjatë TM3 2020 (figura 30). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u zvogëluar për 0.9 pikë përqindje në 19.7 përqind në TM3 2020. Kurse, tek kreditë konsumuese, norma e interesit shënoi rritje për 2.0 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake në 22.2 përqind..

Për dallim nga ekonomitë familjare, tek korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua lehtësisht. Gjatë TM3 2020, norma mesatare e interesit në kreditë e korporatave jo financiare qëndroi në 18.3 përqind, një rënie për 0.3 pikë përqindje krahasuar me TM3 2019. Në aspekt sektorial, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë të orientuara për bujqësinë, të cilat shënuan rënie për 3.2 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake në 17.9 përqind gjatë TM3 2020. Kurse, rritjen më të theksuar shënuan normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, të cilat historikisht kishin kushtet më të favorshme për të marrë kredi, duke arritur në 21.1 përqind gjatë TM3 2020 (rritje për 6.0 pikë përqindje krahasuar me TM3 2019). Ndërsa, norma mesatare për sektorin e industrisë shënoi rënie prej 1.0 pike përqindje duke zbritur në 21.1 përqind në TM3 2020. (figura 31).

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2020)

### Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar gjatë TM3 2020 realizoi fitim më të ulët krahasuar me periudhën paraprake si pasojë e rënies më të theksuar të të hyrave kundrejt

shpenzimeve. Të hyrat e sektorit gjatë këtij tremujori shënuan vlerën 10.7 milionë euro, që paraqet një rënie për 5.1 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie erdhi kryesisht si rezultat i zvogëlimit të të hyrave nga interesi për 5.8 milionë euro, duke zbritur në 9.9 milionë euro gjatë TM3 2020 (figura 32). Të hyrat nga jointerеси u rritën për 0.7 milionë euro gjatë këtij tremujori, duke arritur vlerën në 0.8 milionë euro, që kryesisht reflekton ecurinë e të hyrave nga shërbimet.

Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2020)

Shpenzimet e sektorit shënuan vlerën prej 8.7 milionë euro gjatë TM3 2020, vlerë e cila është për 3.1 milionë euro më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jointerеси (shpenzimet administrative e të personelit dhe provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë), të cilat u zvogëluan për 1.9 milionë euro, në 5.3 milionë euro gjatë TM3 2020. Po ashtu, rënie shënuan edhe shpenzimet e paguara për interesa dhe shpenzimet tjera operative, por në nivel më të ulët. Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave, si një indikator i performancës së sektorit, shënoi rritje për 6.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, duke qëndruar në nivel prej 81.4

përqind në TM3 2020. Kjo do të thotë që për çdo 1 euro të investuar, sektori mikrofinanciar shpenzon rreth 0.814 euro. Rënia më e lartë e të hyrave në krahasim me shpenzimet u përkthye në përgjysmim të fitimit neto gjatë këtij tremujori në 2.0 milionë euro (figura 33).


Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



\*Profiti është analizuar për tremujorin përkatës  
Burimi: BQK (2020)

Performanca financiare e sektorit u reflektua dhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rënie prej 3.3 pikë përqindje dhe 14.1 pikë përqindje përkatësisht krahasuar me TM3 2019 (figura 33).

Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2020)


Sa i përket treguesve të cilësisë së portofolios kreditore

tek institucionet mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione. Deri në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në nivel prej 3.2 përqind, përderisa mbulueshmëria e KJP-ve me provizione deri në fund të TM3 2020 ishte 134.6 përqind (figura 34).

### Tregu i letrave me vlerë

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë dukshëm më të ulët se në tremujorin paraprak (TM2 2020) dhe tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e nivelit të borxhit sovran të emtuar reflekton nevojat e Qeverisë së Kosovës për të financuar aktivitetin e saj përmes këtij instrumenti. Po ashtu, rënia e kërkesës për të emtuar borxh të brendshëm është dhe rezultat i rritjes së nivelit të huazimeve jashtë shtetërore, vlera e të cilave deri në tetor të vitit 2020 arriti në 130.7 milionë euro, kurse vlera e përgjithshme në vitin e kaluar kishte arritur në vetëm 42.9 milionë euro.

Figura 35. Shuma e borxhit të emtuar, rritja vjetore




Burimi: Ministria e Financave (2020)

Gjatë këtij tremujori u realizuan me sukses të gjitha ankandet e planifikuara, ku oferta ishte

**dukshëm më e lartë se sa kërkesa për të emetuar borxh publik.**

Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës në TM3 2020 shënoi rënie vjetore prej 19.0 përqind krahasuar me TM3 2019, duke arritur vlerën prej 85.0 milionë euro (figura 35). Kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të

Figura 36. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave (2020)

tejkalojë ofertën, e që ishte për 1.63 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar, por që krahasuar me vitin e kaluar, është më e ulët. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM3 2020 ishte 2.7 përqind, normë kjo më e lartë se në TM3 2019 për 0.6 pikë përqindje (figura 36).

Rritja e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake reflekton trendin e emetimit të letrave me vlerë drejtë maturimeve afatgjata. Gjatë TM3 2020, mbi 70.0 përqind e letrave me vlerë të emetuara kishin maturitet mbi pesë vite, kurse gjatë TM3 2019 vetëm 38.1 përqind e letrave me vlerë të emetura kishin maturitet mbi pesë vite. Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 5 viteve, pasuar nga ato me maturitet prej 3 viteve. Krahasuar me tremujorët e tretë të viteve paraprake, vlen të potencohet që në dy vitet e fundit nuk kemi emetim të

bonove të thesarit (maturiteti maksimal i të cilave është 364 ditë) (figura 37).

Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2020)

Sektori bankar, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë të vetmet institucione financiare në vend të cilat vazhdojnë të investojnë në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.



**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 32, TM3 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

**Referencat:**

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

**Të tjera (2020):**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2020): Metal Prices database.

FAO (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:  
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2020): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2019	Shtator 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	3,245.3	3,073.9
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.0%	0.3%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	2.4%	-0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,379.3	1,215.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,340.3	1,413.1
Bilanci primar (në milionë euro)	39.1	-197.9
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,006.3	7,671.0
prej të cilave: Bankat	4,577.2	5,036.0
Kredi	2,957.2	3,182.5
Depozita	3,735.6	4,055.4
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.5%	6.4%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.5%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.0%	4.9%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-144.2	-301.8
prej të cilave: remitencat e pranuar	627.6	697.0
Llogaria financiare	-36.5	-293.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	216.4	250.6
Investimet portfolio, net	-23.6	-35.6
Investimet tjera, net	-143.3	-62.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-462.4	-709.7
Asetet	4,912.3	5,076.3
Detyrimet	5,374.7	5,786.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,155.0	2,273.0
Borxhi i jashtëm privat	1,663.2	1,754.4
Borxhi i jashtëm publik	491.7	518.6

Burimi:

1/ ASK (2020);

2/ MF (2020);

3/ BQK (2020).

\*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në qershor 2020.

